

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Për: **KOMUNA E VUSHTRRIË**

Për Aktivitetin e Prokurimit: **644-25-8559-2-2-1**

Sa i përket tenderit për Servisimi dhe mirëmbajtja e paisjeve mjekësore për nevojat e QKMF "Dr. Safet idrizi" Vushtrri për LOT 1 dhe LOT 2 -Servisimin dhe mirembajtjen e pajisjeve mjekësore.

ANKESË

1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK

"PRO MEDICAL SHPK"

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Kadri Zeka

(Adresa)

Ferizaj

700000

(Vendi)

(Kodi postar)

049-631-245

(Numri Telefonit)

(Numri i Faks-it)

Adnan Bala

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

promedical.fr@gmail.com

(Adresa elektronike)



27.04.2026

(Data e parashtrimit të kërkesës)

(Nënshkrimi dhe vula)



2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtrojë kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të kërkesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës].

Njoftimi për kontratë: 23.09.2025
Data e dorzimit 13.10.2025
Vendim i AK 14.04.2026 për Anulim

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

Jo

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

Jo

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmblylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Aktivitet të prokurimit është në kundërshtim me Ligjit të Prokurimit Publik, nr.04/L-042 pra dispozitat e shkelura të LPP-se:

Neni 1- Qëllimi

Neni 59 - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve

Neni 30.4,30.5 të Rregullores Nr. 002/2024

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.

Autoriteti Kontraktues – Komuna e Vushtrrisë, në aktivitetin e prokurimit “Servisimi dhe mirëmbajtja e pajisjeve mjekësore për nevojat e QKMF ‘Dr. Safet Idrizi’ Vushtrri – Lot I dhe Lot II”, ka anuluar aktivitetin dhe ka eliminuar OE PRO MEDICAL SH.P.K. (ankuesin) në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik dhe Rregullores për Prokurimin Publik.

Në fillim Autoriteti Kontraktues – Komuna e Vushtrrisë, në aktivitetin e prokurimit “**Servisimi dhe mirëmbajtja e pajisjeve mjekësore për nevojat e QKMF ‘Dr. Safet Idrizi’ Vushtrri – Lot II**”, në procedurën e lartshënuar ka rekomanduar OE PRO MEDICAL SH.P.K. pra (ankuesin) si fitues për Lot II në vendimin e datës **29.10.2025**, ku për këtë lot është dorëzuar **vetëm një ofertë**, kurse në procedurën e lartshënuar, për **Lot I AK** ka rekomanduar OE “**ATOM-MED**” me vendim të datës 29.10.2025. Pas kësaj, ne kemi paraqitur kërkesë për rishqyrtim tek AK për **Lot I**, AK në mënyrë të njëanshme dhe si formë e reagimit ndaj kërkesës sonë, ka anuluar të gjithë tenderin për të dy Lotot, ndërkohë **OSHP** në dy vendimet e cekura më poshtë (**2025/1237, 2025/1250** dhe **2026/0103**) ka marrë vendim që aktiviteti i prokurimit të kthehet në rivlerësim.

Megjithatë, AK, me të njëjtat arsyetime që tashmë janë shqyrtuar nga OSHP, ka anuluar përsëri tenderin, duke mos zbatuar vendimet e OSHP-së.

Pra, arsyetimet e Autoritetit Kontraktues (AK) për anulimin e aktivitetit të prokurimit dhe eliminimin tonë nga ky aktivitet, përkatësisht lidhur me validitetin dhe sigurimin, tashmë janë shqyrtuar nga **OSHP në vendimin nr. 2026/0103** pra kemi të bëjmë me këtë pretendim si çështje të gjykuar (res judicata) nga **OSHP me Vendimin me nr.2026/0103**.

Gjithashtu, arsyetimet tjera të AK-së lidhur me mungesën e buxhetit janë shqyrtuar në vendimin e OSHP-së nr. **2025/1237 dhe 2025/1250**. Për të dy rastet ekzistojnë vendime të OSHP-së, në të cilat është konstatuar se anulimi i aktivitetit të prokurimit dhe eliminimi ynë kanë qenë në kundërshtim me Ligjin për Prokurim Publik (LPP) edhe ky pretendim është si çështje të gjykuar (res judicata) nga **OSHP me Vendimin me nr. 2025/1237 dhe 2025/1250**.

Rrjedhimisht, me Vendimet e OSHP-së nr. **2025/1237, 2025/1250** dhe **2026/0103**, është konstatuar se vendimi i fundit i Autoritetit Kontraktues është në kundërshtim të drejtpërdrejtë me Ligjin për Prokurimin Publik (LPP), si dhe në kundërshtim me vetë vendimet e OSHP-së, duke shpërfillur konstatimet dhe obligimet që burojnë nga këto vendime.

Qëllimi pse AK është duke tentuar ta anulojë këtë aktivitet të prokurimit dhe ta ritenderojë përsëri, është që në ritenderim t'i ndryshojë kriteret në DT dhe të favorizojë OE-në që ka synuar ta rekomandojë për kontratë, por që kësaj here ka dështuar. Në këtë mënyrë, synohet t'i jepet një rast i dytë për ta fituar këtë tender. Pra, ky është qëllimi primar dhe kryesor pse AK dëshiron ta anulojë këtë tender..

Po ashtu, AK nuk mund të mbështetet në të njëjtat arsyetime për eliminimin tonë, përderisa ato tashmë janë shqyrtuar dhe vlerësuar nga Organi Shqyrtues i Prokurimit, i cili ka konstatuar se ato janë në kundërshtim me LPP.

Në këto rrethana, këto pretendime përbëjnë **çështje të gjykuar (res judicata)**, dhe Autoriteti Kontraktues (AK) nuk mund t'i marrë sërish për bazë të njëjtat arsyetime, pasi ato tashmë janë shqyrtuar dhe janë konstatuar si të kundërligjshme. Konkretisht, arsyetimet për eliminimin tonë dhe anulimin e tenderit në tërësi janë në kundërshtim me Ligjin për Prokurim Publik (LPP) dhe me vendimet e Organi Shqyrtues i Prokurimit.

Sipas Letrës Standarde (LS), ne jemi eliminuar me arsyetimet e cekura në pikat e mëposhtme si :

- *është konstatuar në mënyrë të padiskutueshme se ka mungesë të kontinuitetit juridik të validitetit të tenderit dhe të Sigurimit të Tenderit tuaj.*

Pretendimi 1-Objekti i ankesa: Validiteti i ofertës dhe sigurimi i ofertës në procedurën e prokurimit.

Pretendimi: Autoriteti Kontraktues (AK) nuk ka zbatuar Nenit 30.4 të RrPP-së, duke mos kërkuar nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës vazhdimin e periudhës së validitetit të ofertave dhe sigurimin e tenderit sipas Neni 57 të LPP-së.

Argumentet e ankesa: Mosrespektimi i Nenit 30.4 dhe 30.5 të Rregullores Nr. 002/2024:

AK nuk ka kërkuar vazhdimin e validitetit të ofertave nga operatorët pjesëmarrës. Nuk ka dëshmi në platformën elektronike se AK që procedura apo të ketë ndjekur dispozitat ligjore pra Neni 30.4, pra edhe në shkresën AK ka cituar se nuk ka bërë këtë veprim. Gjendja faktike dhe dëshmitë e depozituara (Prova 2) konfirmojnë shkeljet nga AK se nuk ka zbatuar Nenin 30.4.

Ne kemi dërguar këtë email tek Autoriteti Kontraktues (AK), i cili paraqet Prova 1:

promedical.fr@gmail.com

From: promedical.fr@gmail.com
Sent: Sunday, February 15, 2026 12:09 PM
To: prokurimi.vushtrri@rks-gov.net
Subject: Kërkesë për konfirmim lidhur me vazhdimin e validitetit të ofertës dhe sigurimit - Tenderi nr. 644-25-8559-2-2-1 Servisimi dhe mirëmbajtja e pajisjeve mjekësore për nevojat e QKMF 'Dr. Safet Idrizi' Vushtrri

Të nderuar,

Ju lutemi të na informoni dhe të na konfirmoni nëse ju, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK), për tenderin nr. 644-25-8559-2-2-1 me titull "Servisimi dhe mirëmbajtja e pajisjeve mjekësore për nevojat e QKMF 'Dr. Safet Idrizi' Vushtrri", keni dërguar kërkesë për vazhdimin e validitetit të ofertës dhe sigurimit të ofertës gjatë periudhës kur procedura ka qenë në pezullim dhe lënda ka qenë në shqyrtim pranë OSHP.

Saktësisht, ju lutemi të konfirmoni nëse AK ka dërguar ndonjë njoftim apo kërkesë tek OE në përputhje me nenin 30.4 të Rregullores Nr. 001/2022, e plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren Nr. 002/2024.

Faleminderit për bashkëpunimin

Autoriteti Kontraktues (AK), në përgjigjen e tij ndaj pretendimeve tona, ka kthyer arsyetim shtesë të cilin e kemi paraqitur si Prova 2.

Drejtoria për Prokurim Publik
14 Nr. 62/25
Dt. 16.02.2026

Përgjigje ndaj kërkesës për sqarim – Tenderi nr. 644-25-8559-2-2-1

I nderuar/a,

Në përgjigje të kërkesës suaj të datës 15.02.2026, lidhur me konfirmimin për dërgimin e ndonjë kërkesë nga ana e Autoritetit Kontraktues (AK) për vazhdimin e vlefshmërisë së ofertës dhe sigurimit të tenderit për aktivitetin e prokurimit me titull:

"Servisimi dhe mirëmbajtja e pajisjeve mjekësore për nevojat e QKMF 'Dr. Safet Idrizi' – Vushtrri",

Ju informojmë si vijon:

Autoriteti Kontraktues nuk ka dërguar asnjë kërkesë apo njoftim për zgjatjen e afatit të vlefshmërisë së ofertës dhe sigurimit të tenderit gjatë periudhës kur aktiviteti i prokurimit ka qenë i anuluar dhe në procedurë shqyrtimi pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP).

Në këtë periudhë, procedura ka qenë jashtë administrimit dhe kompetencës operative të AK-së, për shkak të pezullimit faktik dhe juridik të aktivitetit të prokurimit, si pasojë e procedurës ankimore.

Rrjedhimisht, dispozitat e nenit 30 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, lidhur me kërkesën për zgjatje të vlefshmërisë së ofertave, nuk kanë qenë të zbatueshme në rrethanat konkrete.

Për më tepër, obligimi për monitorimin dhe zgjatjen e vlefshmërisë së ofertës dhe sigurimit të tenderit mbetet përgjegjësi e Operatorit Ekonomik, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

Të gjitha këto çështje janë trajtuar dhe arsyetuar në mënyrë të detajuar në vendimin e AK-së për refuzimin e ofertës suaj.

Shpresojmë se ky sqarim është i mjaftueshëm për qëllimet tuaja

Me respekt,

Ilmi Azemi

Drejtore i Drejtorisë
Autoriteti Kontraktues – Komuna e Vushtrrisë



AK duhet të ketë parasysh se procedura e prokurimit udhëhiqet dhe administrohet nga vetë AK, i cili është i obliguar ligjërisht të zbatojë legjislacionin primar dhe sekondar në fuqi, përfshirë edhe nenin 30.4 të Rregullores për Prokurimin Publik.

OE, në anën tjetër, është përgjegjës vetëm për përmbushjen e kërkesave dhe kritereve të përcaktuara sipas Ligjit për Prokurimin Publik (LPP), ndërsa përgjegjësia për menaxhimin dhe zhvillimin e rregullt të procedurës së prokurimit bie mbi Autoritetin Kontraktues.

Pretendimi i AK-së se përgjegjësia për veprimet apo mosveprimet gjatë procedurës bie mbi OE-në është i pabazuar dhe paraqet devijim nga parimet themelore të prokurimit publik. Është juridikisht e papranueshme dhe anomali procedurale që një OE të penalizohet për mosveprim apo lëshimet të AK-së, veçanërisht kur në rastin konkret bëhet fjalë për neglizhencë të vetë Autoritetit Kontraktues.

Në rastin konkret, pasojat e kësaj neglizhence po i atribuohen padrejtësisht OE-së Pro Medical, gjë që cenon parimin e barazisë, proporcionalitetit dhe sigurisë juridike në procedurën e prokurimit publik. Sipas Letrës Standarde (LS), jemi eliminuar me arsyetimet e paraqitura në pikat përkatëse të vendimit të AK. Megjithatë, për secilën prej këtyre pikave kemi paraqitur argumente të detajuara dhe të mbështetura në dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik (LPP), duke dëshmuar se eliminimi ynë është në kundërshtim me ligjin dhe me parimet themelore të prokurimit publik.

Kjo qasje lë të kuptohet për një tendencë diskriminuese ndaj OE Pro Medical dhe krijon perceptimin e një penalizimi të tërthortë për faktin se kemi kërkuar realizimin e të drejtave tona në përputhje me LPP-në.

Nga vendimet e AK-së rezulton se veprimet tona ligjore për mbrojtjen e të drejtave tona po trajtohen si arsye për penalizim, gjë që bie ndesh me parimet e trajtimit të barabartë, mosdiskriminimit, transparencës dhe proporcionalitetit të sanksionuara me LPP. Një qasje e tillë jo vetëm që cenon pozitën juridike të OE Pro Medical, por gjithashtu dëmton integritetin e vetë procedurës së prokurimit.

Kundërshtim ndaj pikës 1 - "Gjendja Faktike"

Përshkrimi i gjendjes faktike nga Autoriteti Kontraktues është i pasaktë juridikisht i pabazuar për arsyet në vijim:

Është e vërtetë që vendimi për anulim është marrë më 05.12.2025 dhe lënda ka qenë në shqyrtim pranë OSHP-së.

-Lidhur me pretendimin për skadim të validitetit, AK me datën 11.12.2025 publikon Konkluzioni - Pezullimi pas ne kemi dorzuar Kërkesë për Rishqyrtim, pas refuzimit ne kemi dorzuar Ankesë në OSHP dhe AK me datë 22.12.2025 publikon Konkluzion - Pezullim i përkoheshëm pas Ankesës dorzuar ne OSHP. Sipas vendimit të OSHP-së AK publikon njoftimin më datë 04.02.2026, anulohet Vendimi B58 e datës 14.04.2026 pra nga rivlersimi.

Në zbatim të vendimit të OSHP-së, procedura e prokurimit rikthehet në fazën e rivlerësimit, përfshirë edhe ofertën e OE-së sonë.

Si rrjedhojë e vendimit të OSHP-së, oferta jonë rikthehet në rivlerësim dhe ruan validitetin e saj, përfshirë sigurimin e ofertës aktiv (shiko në e prokurim qe kemi dorzuar vazhdimin validitetit dhe sigurimin), duke përmbushur të gjitha kriteret ligjore dhe procedurale sipas Rregullores Nr. 002/2024.

Megjithatë, konstatimi se OE ka lejuar 'shkëputje të kontinuitetit' është i pabazuar dhe jo i mbështetur në fakte sepse AK nuk ka kërkuar një till sipas Neni 30.4 të RrP. Aktiviteti i prokurimit ka qenë i pezulluar, ndërsa OE Pro Medical ka vepruar në kohë, duke dorëzuar në mënyrë vullnetare dhe **proaktive vazhdimin** e validitetit të ofertës dhe sigurimit të ofertës pra ju keni cekur ne vetë kemi bërë këtë veprim.

Ju si OE keni pasur për obligim që të monitoroni afatin e vlefshmërisë të ofertës tuaj dhe të Sigurimit të tenderit si dhe të ndërmarri veprime të nevojshme për zgjatjen e vlefshmërisë të tenderit dhe të Sigurimit të tenderit tuaj në mënyrë proaktive, pavarësisht fazës procedurale.

Kurse Neni 30.3 i Rregullores për Prokurimin Publik, **kërkon rreptësisht që oferta të ketë validitet deri të dhënia dhe nënshkrimi i kontratës.** d.m.th valide deri në dhënia dhe nënshkrimi i kontratës.

- Më 15.12.2025 (ditë hëne sepse 13 dhe 14 kanë qenë vikend), ne OE kemi dorëzuar deklaratë me shkrim për vazhdimin e validitetit për 60 ditë shtesë, dhe të njetin e kemi vazhduar përsëri dhe vendim tjetër dhe sigurimin me 04.02.2026.

- Zgjatja është bërë në mënyrë vullnetare, ndonëse sipas Nenit 30.4 të Rregullores Nr. 002/2024, obligimi për të kërkuar zgjatjen bie mbi Autoritetin Kontraktues.

Dispozita është e qartë:

“Autoriteti Kontraktues do të kërkoj nga Operatorët Ekonomik të zgjasin validitetin e tenderëve të tyre. Autoriteti Kontraktues do të verifikojë që të gjithë tenderët pranojnë kërkesën për zgjatjen e validitetit të tenderit.”

Në rastin konkret, AK nuk ka bërë asnjë kërkesë zyrtare , siç kërkohet shprehimisht nga dispozita e cekur më lartë.

Përgjegjësia për kontinuitet nuk bie mbi OE, sepse AK ka qenë obliguar të zbatojë Neni 30.4 të Rregullores Nr. 002/2024

AK pretendon se vazhdimi është dashur të bëhet “pa shkëputje” kurse Neni 30.3 i Rregullores për Prokurimin Publik, **kërkon rreptësisht që oferta të ketë validitet deri te dhënia dhe nënshkrimi i kontratës. d.m.th valide deri në dhënia dhe nënshkrimi i kontratës.**

Megjithatë:

- Rregullorja nuk e ngarkon OE me detyrimin për të monitoruar dhe inicuar vazhdimin e validitetit.
- Neni 30.4 e vendos qartë përgjegjësinë mbi AK

30.4 Në situata të justifikueshme dhe/ose të veçanta kur vonesa të papritura shfaqen, duke nënkuptuar që procesi i vlerësimit nuk mund të finalizohet brenda afatit të periudhës së validitetit të tenderëve për arsye të detajeve komplekse teknike të sqaruara, AK do të kërkoj nga OE të zgjasin validitetin e tenderëve të tyre. Kërkesa për zgjatje të validitetit të tenderit do të bëhet me shkrim dhe duhet të kërkohet para datës së skadimit dhe duhet të ngritet në sistem (është e rëndësishme të verifikohet që të gjithë tenderët pranojnë kërkesën për zgjatjen e validitetit të tenderit)

- Vetëm pas kërkesës së AK-së, OE ka të drejtë të vendosë nëse do ta zgjasë apo jo validitetin, sipas Nenit 30.6.

30.6 Është e hapur për secilin OE të vendosë nëse dëshiron të zgjatë validitetin e tenderit. OE të cilët vendosin të mos zgjasin validitetin e tenderëve të tyre do të refuzohet si “të papërgjegjshëm” dhe kështu AK nuk do të konfiskoj Sigurimin e Tenderit të tyre.

Po ashtu, Neni 30.5 përcakton:

“Nga të gjithë tenderët do të kërkohet që gjithashtu të zgjasin validitetin e sigurimit të tenderit të tyre.”

Në rastin konkret, AK nuk ka ndërmarrë këtë veprim, megjithëse ka qenë e obliguar me dispozitë imperative (“do të kërkojë”), pra dispozitë imperative është rregull juridik i detyrueshëm, nga i cili AK nuk mund të devijojnë nga detyrim e caktuar ne Neni 30.4 dhe 30.5 të Rregullores Nr. 002/2024 .

Pra dispozita është imperative (“do të kërkojë”) dhe nuk parashihet asnjë përjashtim në rast të pezullimit të aktivitetit për shkak të procedurave ankimore.

Përkundrazi, situatat kur një aktivitet është në shqyrtim pranë OSHP-së përbëjnë pikërisht “vonesa të papritura” në kuptim të kësaj dispozite.

Në mungesë të kërkesës nga AK, OE nuk mund të penalizohet për një “shkëputje” që ka ardhur si rezultat i mosveprimit të AK-së.

-Lidhur me pretendimin për pavlefshmëri të deklaratës të Pro Medical nga AK.

AK pretendon se deklarata është e parregullt sepse nuk janë specifikuar datat e fillimit dhe përfundimit.

Ky arsyetim është formalist dhe jo proporcional, sepse:

- Deklarata specifikon qartë periudhën shtesë prej 60 ditësh;
- Nuk ka asnjë dispozitë që e shpall të pavlefshme një deklaratë për shkak të mungesës së specifikimit eksplisit të datës kalendarike, kur periudha kohore është e qartë;

Deklarata e Pro Medical e dorëzuar në mënyrë vullnetare .

VENDIM PËR VAZHDIMIN E VALIDITETIT TË OFERTËS

Ne, **PRO MEDICAL**, si operator ekonomik pjesëmarrës në aktivitetin e prokurimit: **"Servisimi dhe mirëmbajtja e paisjeve mjekësore për nevojat e QKMF "Dr. Safet idrizi" Vushtrri"** me numër të prokurimit **644-25-8559-2-2-1**, dhe në bazë vullnetare, pasi nuk kemi marrë ndonjë kërkesë nga AK, pra ne bëjmë vazhdimin e validitetit të ofertës sonë.

Në këtë kontekst:

- **Validiteti i ofertës sonë zgjatet për një periudhë shtesë prej 60 ditësh.**

Ky vendim është marrë në përputhje me dispozitat e **Ligjit për Prokurimin Publik**, si dhe në funksion të përkushtimit tonë për të siguruar vazhdimësinë dhe përmbushjen e kërkesave të aktivitetit përkatës të prokurimit.

-Lidhur me sigurimin e tenderit

Pretendimi për "shkëputje" në sigurimin e tenderit nuk mund të përdoret si bazë për eliminim, për arsye se:

- Sigurimi i tenderit ndjek validitetin e ofertës; OE Pro Medical ka vepruar **proaktivisht** për ruajtjen e validitetit të ofertës i cili akoma është valid deri 05.05.2026(shiko tek Dokumentet - Letrat standarde janë ngarkuar).
- Mosinicimi i kërkesës për zgjatje nga AK sipas Neni 30.4 ka ndikuar drejtpërdrejt në këtë situatë;
- OE ka vepruar në mirëbesim dhe ka bërë zgjatjen vullnetarisht, ndonëse obligimi ligjor për inicim ishte i AK-së sipas Neni 30.4 dhe 30.5.

Nuk mund të penalizohet OE për pasojat e moszbatimit të detyrimeve ligjore nga ana e AK-së.

- Ne Pro Medical kemi bërë zgjatjen validiteti dhe sigurimin në mënyrë vullnetare.
- AK nuk ka përmbushur obligimin ligjor sipas Neni 30.4 të Rregullores Nr. 002/2024.
- Pretendimi për "shkëputje" është pasojë e drejtpërdrejtë e mosveprimit të AK-së.
- Penalizimi i OE në këto rrethana bie ndesh me Neni 30.4 dhe 30.5 të Rregullores Nr. 002/2024 dhe me parimin e proporcionalitetit në prokurim publik.

Për rrjedhojë, konstatimi i AK-së lidhur me pavlefshmërinë e deklaratës dhe sigurimit është i pabazuar dhe nuk mund të shërbejë si bazë ligjore për eliminimin e OE.

2. Kompetenca e AK-së gjatë shqyrtimit të ankesës në OSHP

AK pretendon se gjatë periudhës kur lënda ka qenë në shqyrtim pranë OSHP-së, nuk ka pasur kompetencë operative për të ndërmarrë veprime procedurale. Kjo hera e pare nja arsyetim i till nga AK dhe cili bie ndesh me obligimet ligjore që ZPP.

Ne e kundërshtojmë këtë arsyetim sepse nuk ka bazë ligjore se:

Sipas Neni 30.4 të Rregullores Nr. 002/2024, obligimi për të kërkuar zgjatjen e validitetit të ofertave bie mbi AK-në, duke qenë se dispozita është imperative ("**do të kërkojë**") pra **30.4 AK do të kërkojë nga OE të zgjasin validitetin e tenderave të tyre.**

Pezullimi i aktivitetit nuk përjashton këtë obligim administrativ. Situata e shqyrtimit pranë OSHP-së përbën pikërisht rastin e vonësive të papritura, ku AK duhet të kërkojë zgjatjen validitetin.

Përgjegjësia për monitorimin e validitetit nuk mund të bartet në mënyrë ekskluzive mbi OE siq pretendon AK (shiko më poshtë) , sipas **Neni 30.4 të Rregullores Nr. 002/2024**, OE mund të veprojë vetëm pas një **kërkesë formale nga AK-ja**. Pas marrjes së kësaj kërkesë, OE ka mundësinë të veprojë ose të mos veprojë sipas **Neni 30.6**, duke respektuar procedurat e parashikuara.

Kjo nënvizon se **përgjegjësia nuk mund të transferohet automatikisht te OE**, dhe çdo penalizim që bazuar vetëm mbi këtë supozim bie ndesh me parimin e proporcionalitetit dhe me dispozitat e Rregullores.

Për më tepër, obligimi për monitorimin dhe zgjatjen e vlefshmërisë së ofertës dhe sigurimit të tenderit mbetet përgjegjësi e Operatorit Ekonomik, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

Të gjitha këto çështje janë trajtuar dhe arsyetuar në mënyrë të detajuar në vendimin e AK-së për refuzimin e ofertës suaj.

Shpresojmë se ky sqarim është i mjaftueshëm për qëllimet tuaja

Me respekt,

Ilmi Azemi

Drejtor i Drejtorisë
Autoriteti Kontraktues – Komuna e Vushtrrisë



Pra, pretendimi i AK-së për “mungesë kompetence operative” nuk është juridikisht i bazuar dhe nuk e heq përgjegjësinë për zbatimin e Nenet 30 dhe LPP.

Citim i i AK”

Në periudhën kur lënda ka qenë në procedurë ankimi pranë OSHP-së, Autoriteti Kontraktues nuk ka pasur kompetencë operative për të ndërmarrë veprime procedurale lidhur me vlerësimin apo administrimin e ofertave. Procedura ka qenë jashtë kontrollit efektiv të AK-së dhe në pritje të vendimit të organit kompetent, çka përbën pezullim

Por ju si AK duhet të keni parasysh se Pezullimi nuk përbën pamundësi juridike nuk do të thotë se:

- Pezullimi i procedurës ose i një vendimi **nuk e bën juridikisht të pamundur** veprimin;
- Ai vetëm **ndalon përkohësisht efektet ose vazhdimin e procedurës si vlerësim, nënshkrim e kontratës**, por nuk e shuan të drejtën e zbatimit të detyrimeve sipas Neni 30.4 dhe 30.5 të Rregullorja Nr. 002/2024.

Në kontekstin e prokurimit publik, pezullimi:

- Nuk e bën ofertën të pavlefshme;
- Nuk e përjashton automatikisht OE-në;
- Nuk krijon “pamundësi objektive” për të vepruar, përveçse ndalon procedurën deri në vendimin përfundimtar.

Masa e pezullimit ka efekt procedural dhe të përkohshëm, por nuk krijon pamundësi juridike për AK dhe OE-në.”

dhe

- **Pezullimi nuk ndikon zbatimin e Neni 30.4 në validitetin e ofertës, por vetëm suspendon përkohësisht procedurën e vlerësimit.**

As Ligji për Prokurimin Publik dhe as legjislacioni dytësor nuk e përkufizojnë “pezullimin” si ndalim absolut të çdo veprimi administrativ.

Sipas interpretimit të KRPP-së, pezullimi nënkupton mosndërmarrjen e veprimeve procedurale substanciale (**hapje ofertash, vlerësim, nënshkrim kontrate**). Megjithatë, kërkesa për zgjatje të validitetit të ofertave:

- nuk cenon procesin e shqyrtimit,
- nuk ndryshon rezultatin e procedurës,
- nuk përbën veprim të ndaluar procedural,

Prandaj, nuk mund të pretendohet “pamundësi objektive” në kuptimin juridik të termit.

Rregullorja Nr. 002/2024 nuk parasheh asnjë përjashtim nga zbatimi i Neni 30.4 në rast pezullimi. Përkundrazi, situatat kur aktiviteti është në shqyrtim në OSHP përbëjnë “vonesa të papritura” në kuptim të kësaj dispozite.

Pezullimi nënkupton mosndërmarrje të veprimeve substanciale (vlerësim, nënshkrim kontrate), por nuk ndalon veprimet administrative.

Mosveprimi i AK-së përbën neglizhencë në ushtrimin e detyrimeve ligjore dhe bie ndesh me nenin 97 të Rregullores, i cili trajton shkeljet e rënda pra **pikë f. Mos zbatimi i nenit 30.4 të Rregullores së Prokurimit Publik nga zyrtari përgjegjës i prokurimit.**

Ne e kundërshtojmë këtë arsyetim të AK sepse:

Neni 30.4 përcakton qartë se në situata të vonesave të papritura, **AK duhet të kërkojë** nga OE të zgjasin validitetin e tenderëve dhe të sigurojë që kjo kërkesë të pranohet ose jo siq e përcakton Neni 30.6 i Rregullores Nr. 002/2024 .

OE Pro Medical veprimi vullnetarisht për të zgjeruar validitetin dhe sigurimin e tenderit, por kjo nuk e heq përgjegjësinë e AK-së për të kërkuar zgjatjen formalisht.

Prandaj, arsyetimi i AK-së është i paqëndrueshëm, dhe penalizimi i OE për “mosveprim” bie mbi neglizhencën e AK-së.

Kjo nënkupton se Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit ka pasur detyrim ligjor aktiv të monitorojë afatet dhe mosveprimi i AK-së nuk mund të justifikohet me interpretim të zgjeruar të parimit “Impossibilium nulla obligatio est”, sepse në rastin konkret nuk ka ekzistuar pamundësi faktike apo juridike, por vetëm neglizhencë në ushtrimin e detyrimeve ligjore.

Bazuar në nenin 30.4 dhe 30.5 të Rregullores për Prokurimin Publik, si dhe në sqarimet e KRPP-së, rezultoi se:

- AK ka pasur obligim të qartë ligjor të kërkojë zgjatjen e validitetit të ofertave,
- pezullimi i aktivitetit nuk e përjashton këtë obligim,
- mosveprimi përbën shkelje të nenit 30.4 dhe klasifikohet si shkelje e rëndë sipas nenit 97 të Rregullores.

3. Përgjegjësia e Operatorit Ekonomik

AK pretendon se OE ka përgjegjësi për të monitoruar validitetin dhe sigurimin e tenderit, pavarësisht fazës procedurale.

Arytimim i AK është i pa bazuarë në LPP dhe Rregullores Nr. 001/2022 sepse:

Përgjegjësia e OE aktivizohet vetëm pas kërkesës formale të AK-së, sipas Nenit 30.6.

OE ka vepruar vullnetarisht për të ruajtur validitetin dhe sigurimin e tenderit.

Shkelja e pretenduar nuk mund t'i atribuohet OE, pasi AK nuk ka dërguar kërkesën formale për zgjatje sipas Nenit 30.4 dhe 30.5.

5. Efekti juridik i skadimit

AK pretendon se skadimi i validitetit dhe sigurimit e bën ofertën juridikisht të pavlefshme. Kjo nuk qëndron dhe nuk ka bazë ligjore sipas LPP sepse:

Oferta ka qenë e vlefshme dhe e siguruar, pasi OE ka vepruar sipas Nenit 30.6.

Mosveprimi i AK-së nuk mund të krijojë pasojë juridike negative për OE, sepse përgjegjësia për iniciativën ligjore për zgjatjen e validitetit bie mbi AK siq kemi cekur më lartë.

OE Pro Medical ka siguruar që oferta jonë të jetë dhe të mbetet valide gjatë procesit të rivlerësimit (RIVLERSIM), në përputhje me vendimin përkatës të OSHP-së, i cili garanton qartë se veprimet e OE për ruajtjen e validitetit nuk mund të penalizohen kur kryhen sipas procedurave dhe në kohën e duhur.

Pro Medical ka vepruar proaktivisht për ruajtjen e validitetit të ofertës gjatë rivlersimit që AK nuk ka marrë parasysh këtë dhe ju si AK duhet keni parasysh Neni 30.3 i Rregullores për Prokurimin Publik, **kërkon rreptësisht që oferta të ketë validitet deri te dhënia dhe nënshkrimi i kontratës.** d.m.th valide **deri në dhënia dhe nënshkrimi i kontratës.**

Lidhur me pretendimin 1 shikon edhe Vendim e OSHP me nr. 2026/0103.

Duke marrë parasysh të gjitha sa u theksuan më lart, eliminimi i OE “Pro Medical” është në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi, si dhe me vendimet e OSHP-së. Rrjedhimisht, kërkojmë që ky vendim të anulohet dhe lënda të kthehet në rivlerësim, në përputhje me dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik (LPP).

Ritheksim aktiviteti i prokurimit ka qenë në shqyrtim pranë OSHP-së dhe nuk heq përgjegjësinë e AK-së për të kërkuar zgjatjen e validitetit sipas Nenit 30.4 dhe 30.5 gjithashtu edhe për OE Neni 30.6 të Rregullores Nr. 002/2024;

OE Pro Medical ka vepruar vullnetarisht dhe ka ruajtur validitetin dhe sigurimin e tenderit; Penalizimi i OE është rezultat i mosveprimit dhe neglizhencës së AK-së;

Oferta konsiderohet e vlefshme dhe e siguruar, dhe nuk mund të përjashtohet nga vlerësimi për shkak të mungesës së veprimeve të AK-së, arsyetimi i AK-së është i pabazuar dhe nuk ka bazë ligjore.

Pretendimi 2-Objekti i ankesës: Mungesa e mjeteve financiare në procedurën e prokurimit.

Pavarësisht kësaj, anulimi zyrtarë nga AK është bërë me vendimin e datës 14.04.2026 i cili bie ndesh me Ligjin për Prokurimin Publik (LPP), Neni 62, pasi një veprim i tillë përbën shkelje flagrante të dispozitave ligjore. Ky vendim është i pambështetur juridikisht dhe për nga natyra paraqet vendim arbitrar, duke mos respektuar kriteret dhe kushtet e parashikuara në Nenin 62 të LPP-së.

Arsyetimi i AK në Vendimin për Anulim të datës 14.04.2026 është i mbështetur gabimisht në Nenin 9 të LPP-së, nuk qëndron, pasi paragrafi 1 i këtij neni përcakton qartë: "Para se të fillohet me ushtrimin e çfarëdo aktiviteti të prokurimit...", dhe jo në fazën e rivlerësimit, ashtu siç pretendon AK. Për rrjedhojë, interpretimi i AK-së është i pasaktë dhe i përdorur në mënyrë të gabuar për të justifikuar anulimin e aktivitetit të prokurimit.

Po ashtu, arsyetimi i AK-së i bazuar në nenet 8.1 dhe 8.5 të Rregullores Nr. 001/2022, të plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren Nr. 002/2024, nuk qëndron. Këto dispozita të rregullores kanë të bëjnë me kushtet dhe procedurat para inicimit të prokurimit, dhe jo me ndërhyrje gjatë procesit të rivlerësimit pas një kërkesë për rishqyrtim. Për këtë arsye, referimi i AK-së ndaj këtyre neneve është i pambështetur juridikisht dhe bie ndesh me kuadrin ligjor të prokurimit publik. Para se të fillohet me ushtrimin e çfarëdo aktiviteti të prokurimit e jo siç pretendon AK gjatë rivlersimit.

Në këtë rast, AK nuk ka pasur asnjë bazë ligjore për anulim sipas Nenit 62 të LPP-së, sepse:

- 1. Mjetet financiare kanë qenë plotësisht të disponueshme për këtë aktivitet të prokurimit;***
- 2. Procedura është inicuar dhe zhvilluar konform LPP-së, pa asnjë indikator të shkeljes së pakorrigjueshme.***

Kjo është Kontratë Publike Kornizë – Shërbim për periudhë 36-mujore, prandaj nuk kemi të bëjmë me furnizim apo punë, por me shërbime esenciale dhe sensitive që ndikojnë direkt në pacientë.

Pas parashtrimit të kërkesës për qasje në dokumente publike pranë institucionit përkatës, kemi siguruar se për projektin në fjalë kanë qenë të planifikuara, të siguruara dhe të zotuar mjete buxhetore, të evidentuara në kodin buxhetor **014050**, i cili bën pjesë në kategoritë e shpenzimeve buxhetore sipas klasifikimit ekonomik. Pra në Kategorinë e Shpenzimeve sipas dëshmimeve mjetet buxhetore në prej 66,574.00 euro kanë qenë të planifikuara për çdo vitë për një periudhë trevjeçare, ndërsa procesi i zotimit dhe planifikimit të tyre është realizuar në baza vjetore, në përputhje me planifikimet dhe ndarjet buxhetore të miratuara.

Pra, arsyetimi i Autoritetit Kontraktues (AK) nuk qëndron, pasi mjetet financiare për këtë aktivitet janë të buxhetuara në kuadër të sektorit të shëndetësor (74444) kodin 014050, në **FORMULARI I SHPENZIMIT TË DEPARTAMENTIT, DIVIZIONIT OSE SEKTORIT**, në **PJESA IV: KATEGORITË E SHPENZIMEVE**. (nga formulari)

14000	MIREMBAJTJA	163,485.5	93,124.0	108,574.0	108,574.0	108,574.0
14010	Mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve	17,500.0	15,000.0	15,000.0	15,000.0	15,000.0
14024	Mirëmbajtja e ndërtesave shëndetësore	22,000.0	10,000.0	17,000.0	17,000.0	17,000.0
14040	Mirëmbajtja e Teknologjisë Informative dhe të Komunikimit	10,000.0	10,000.0	10,000.0	10,000.0	10,000.0
14050	Mirëmbajtja e mobiljeve dhe pajisjeve	113,985.5	58,124.0	66,574.0	66,574.0	66,574.0
14400	SHPENZIMET PËR VENDIMET E GJYKATAVE	2,316.5	2,316.5	2,000.0	2,000.0	2,000.0

Sa për informim, buxheti për vitin 2026 është aprovuar nga Kuvendi Komunal i Vushtrrisë si dhe nga MFPT është vendosur në BDMS dhe PIP, dhe është miratuar brenda afateve ligjore. Pra, mjetet financiare janë zotuar dhe buxhetuar për tendering ku ne kemi qënë rekomanduar për kontratë.

Shihet qartë se qëllimi i AK-së është eliminimi i Pro Medical dhe mohimi i së drejtës për nënshkrimin e kontratës për një aktivitet të prokurimit, edhe pse ne kemi përmbushur të gjitha kriteret e Dosjes së Tenderit.

Vlerësojmë se AK ka për qëllim diskriminimin e OE "Pro Medical" lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, duke u arsyetuar se nuk ka mjete financiare, edhe pse këto mjete kanë qenë të planifikuara në buxhet.

Si informacione shtesë dhe sekondare (në mënyrë indirekte, lidhur me pretendimin tonë):

Si një anomali shtesë, AK ka hapur një tender të ri nga Kategori Shërbimeve, me vlerë prej 886,800.00 €, për projektin me titull: "Kontraktimi i shërbimeve profesionale sociale dhe shëndetësore në QKMF 'Dr. Safet Idrizi' dhe në shtëpi tek pacientët në Komunën e Vushtrrisë". Gjithashtu, ky aktivitet nuk është i përfshirë fare në planin e prokurimit për vitin 2026. Kjo tregon se për këtë projekt janë siguruar mjete financiare dhe se nga ky projekt nuk janë marrë mjete financiare për përmbarues apo për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore. Sipas AK-së, mjetet janë marrë vetëm dhe konkretisht nga projekte/tendera ku ne kemi qenë fitues. Po ashtu, AK nuk ka ndërmarrë asnjë veprim që aktiviteti i prokurimit i filluar, ku ne kemi qenë OE i rekomanduar dhe më pas i eliminuar, të përfundojë. Kjo dëshmon qartë se AK ka pasur për qëllim diskriminimin e OE "Pro Medical.

Ne kemi dorëzuar edhe një email zyrtar tek Drejtori për Buxhet dhe Financa në KK Vushtri, mirëpo nuk kemi pranuar përgjigje. Andaj, kërkojmë nga eksperti shqyrtues i prokurimit që të ndërmarrë hapat e nevojshëm për të dëshmuar gjendjen reale faktike, përfshirë sigurimin e **FORMULARI I SHPENZIMIT TË DEPARTAMENTIT, DIVIZIONIT OSE SEKTORIT , në PJESA IV: KATEGORITE E SHPENZIMEVE**, me qëllim të verifikimit të gjendjes reale financiare.

Pro Medical <promedical.fr@gmail.com>
To: isuf.jashari@rks-gov.net

Thu, Apr 23, 2026 at 9:22 AM

I nderuar drejtor,

Në cilësinë e palës së interesuar, unë [REDAKTUAR] si përfaqësues i OE "PRO MEDICAL SH.P.K.", ju drejtohem lidhur me mjetet buxhetore që kanë qenë të planifikuara, të siguruar dhe të zotuar në kuadër të kodit buxhetor 014050 pra pra në kuadër të kodin 74450 , pjesë e kategorive të shpenzimeve sipas klasifikimit ekonomik. Sipas të dhënave në dispozicion, mjetet buxhetore në shumën prej 66,574.00 € kanë qenë të planifikuara për secilin vit, për një periudhë trevjeçare, ndërsa procesi i planifikimit dhe zotimit është realizuar në baza vjetore, në përputhje me ndarjet buxhetore të miratuara. Buxheti për vitin 2026 është aprovuar nga Kuvendi Komunal i Vushtrrisë dhe, sipas praktikës, është proceduar për përfshirje në BDMS dhe PIP nga MFPT, brenda afateve ligjore. Rrjedhimisht, konsiderojmë se mjetet janë të planifikuara dhe të zotuar në mënyrë të rregullt.

Për qëllime të qartësisht të plotë të gjendjes faktike dhe financiare, ju lutemi të na sqaroni si vijon:

- 1. A mund të konfirmoni zyrtarisht nëse fondet e zotuar në këtë kod buxhetor 014050 janë përdorur, ridestinuuar apo bllokuar?**
- 2. Në rast se fondet janë tërhequr nga përmbaruesit , ju lutemi të specifikoni:**
 - emrin e përmbaruesit që ka ndërmarrë veprimin,
 - datën e ndërhyrjes,
 - shumën e saktë të mjeteve të tërhequra dhe llogarinë buxhetore nga e cila janë marrë.
- 3. Ju lutemi të sqaroni mbi bazën e cilit vendim apo procedure janë prekur këto fonde dhe nëse është respektuar procedura e rregullt buxhetore për këtë ndryshim.**
- 4. A ekziston ndonjë vendim apo shkresë zyrtare nga Drejtorja e Financave apo ndonjë organ tjetër kompetent që dëshmon përmbarimin apo ndryshimin e disponueshmërisë së mjeteve? Nëse po, ju lutemi të bashkëngjiti dokumentacionin përkatës.**
- 5. Cila është gjendja aktuale e mjeteve buxhetore në kodin ekonomik të destinuar për këtë aktivitet?**
- 6. Për projektin me titull "Kontraktimi i shërbimeve profesionale sociale dhe shëndetësore në QKMF 'Dr. Safet Idrizi' dhe në shtëpi tek pacientët në Komunën e Vushtrrisë", me vlerë të parashikuar 886,800.00 €, ju lutem të na informoni se në cilin kod buxhetor është klasifikuar dhe nëse është i paraparë në Planin e Prokurimit për vitin fiskal përkatës?**

Këto informata janë të domosdoshme për vlerësimin e saktë të gjendjes faktike financiare.

Ju lutemi që përgjigjen dhe dokumentet përkatëse t'i dërgoni përmes email-it. Mospërgjigjja ndaj kësaj kërkesë deri më datën 27.04.2026 ora 12:00, do të konsiderohet si refuzim i dhënies së informatave të kërkuara.

Faleminderit për bashkëpunimin

Megjithatë, AK ka tentuar ta arsyetojë anulimin duke u mbështetur në Nenin 62, paragrafin 1.1 të LPP-së, i cili përcakton: "kur një shkelje e ligjit aktual ka ndodhur apo do të ndodhë në procedurën e prokurimit, e cila nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një amendamenti ligjor të kushteve të prokurimit, duke përfshirë edhe rastet ku një dispozitë e këtij ligji kërkon anulimin e aktivitetit të prokurimit."

Në rastin konkret, nuk ekziston asnjë shkelje e tillë, as e ndodhur dhe as e parashikuar, e cila:

- nuk mund të rregullohej,
- nuk mund të parandalohet,

Prandaj, referimi i AK-së në Nenin 62, paragrafi 1.1 është i pavlefshëm juridikisht, i pambështetur në fakte konkrete, dhe nuk mund të shërbejë si bazë ligjore për anulimin e aktivitetit të prokurimit.

Këto veprime përbëjnë diskriminim të qartë nga AK, në shkelje të Nenit 7 të LPP-së, pasi kompania jonë është trajtuar në mënyrë të pabarabartë dhe e pafavorshme pa asnjë arsye ligjore.

Shkeljet tjera të LPP-së nga Autoriteti Kontraktues janë si vijon:

Neni 1- Qëllimi -E kundërshtojme vendimin e Autoritetit Kontraktues ngase i njeiti është në kundërshtim me nenin 1 te Ligjit per Prokurim Publik dhe paragrafin nuk ka marre ne konsiderate detyrimin.

AK në këtë rastin tonë ka shkelur Nenin 1 paragrafin 2 të LPP citim *“Ky ligj gjithashtu ka për qëllim të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji”*

Neni 59 - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve-Sipas Nenit 59 të LPP-së, Autoriteti Kontraktues është i obliguar të kryejë vlerësimin e ofertave në përputhje të plotë me dispozitat ligjore dhe me kushtet e përcaktuara në Dosjen e Tenderit (DT) dhe Njoftimin për Kontratë (NJK) sipas Nenit 59 paragrafi 4 dhe në rast se një Operator Ekonomik i përbush të gjitha kriteret e kërkuara, atëherë AK, duke zbatuar procedurën e vlerësimit, është i detyruar të rekomandojë dhënien e kontratës.

Vetëm në situatën kur asnjë Operatori Ekonomik nuk përbush kriteret e përcaktuara në DT dhe NJK, atëherë AK mund të anulojë aktivitetin e prokurimit konform Rregullores së Prokurimit Publik (RrPP) Nr. 002/2024, Neni 43.5 pika b, e cila parasheh anulimin kur: *“asnjëri prej tenderëve të pranuar nuk është i përgjegjshëm”*. Në rastin konkret, ky kriter nuk aplikohet, sepse Pro Medical i ka përbushur të gjitha kërkesat e përcaktuara nga AK, gjë që është provuar edhe nga fakti se AK, gjatë procedurës së vlerësimit paraprak, ka rekomanduar dhënien e kontratës.

Arsyetimi i AK-së nuk qëndron

Pretendimi i AK-së për anulim nuk ka bazë ligjore dhe nuk mund të përdoret për të penalizuar OE, pasi:

- Ne si operator ekonomik nuk jemi përgjegjës për menaxhimin e financave publike,
- Mosveprimet ose gabimet e autoritetit nuk mund të transferohen si barrë te një kompani që ka përbushur plotësisht kërkesat ligjore,

AK duke anuluar aktivitetin e prokurimit duke u mbështetur gabimisht në Neni 9 të , Nenin 62 të LPP-së dhe në Nenin 8.5 të RrPP Nr. 002/2024, AK ka vepruar:

- *në kundërshtim të drejtpërdrejtë me kuadrin ligjor,*
- *pa asnjë bazë të vlefshme ligjore për anulim,*
- *dhe ka krijuar një situatë të diskriminimit të Pro Medical, e cila ka përbushur të gjitha kushtet dhe është rekomanduar fillimisht për kontratë.*

Për këto arsye, vendimi i AK për anulimin e aktivitetit të prokurimit është:

- i paligjshëm,
- i paarsyeshëm,
- i pambështetur në Nenin 9 të LPP-së,
- dhe në kundërshtim të plotë me Nenin 62 të LPP-së dhe Nenin 43 të RrPP Nr. 002/2024.

Ky veprim ka cenuar të drejtën tonë ligjore dhe ka diskriminuar kompaninë Pro Medical në këtë procedurë. Vendimi i AK-së për anulimin e tenderit është marrë në kundërshtim të plotë me Ligjin për Prokurimin Publik, konkretisht me nenin 62, si dhe me dispozitat e Rregullores Nr. 002/2024 për Prokurimin Publik, përkatësisht nenet 43.5, 43.7, si dhe me nenin 7 të LPP-së.

Ky veprim i AK-së lë të kuptohet se ka ekzistuar një qëllim diskriminues ndaj kompanisë sonë Pro Medical, duke na mohuar të drejtën ligjore , pavarësisht se kemi plotësuar të gjitha provat dhe kriteret juridike të kërkuara.

Për më tepër, AK nuk ka të drejtë të anulojë procedurën e prokurimit pas përfundimit të procesit të vlerësimit, në pajtim me nenin 59 të LPP-së, dhe ku ka OE të përgjeshëme.

Neni 62-Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit i LPP-së përcakton qartë rastet dhe kushtet se kur mund të përfundojë një aktiviteti të prokurimit. Po ashtu, neni 43.5 i Rregullores Nr. 002/2024 për Prokurimin Publik specifikon situatat e lejuara kur Autoriteti Kontraktues mund të ndërpresë ose anulojë një procedurë të prokurimit.

Megjithatë, arsyetimi i dhënë nga AK për ndërprerjen/anulimin e kësaj procedure nuk përfshihet në asnjërën nga këto dispozita ligjore.

Prandaj, AK është i obliguar që çdo veprim ta ndërmarrë në përputhje të plotë me LPP-në dhe Rregulloren për Prokurimin Publik, duke siguruar ligjshmërinë dhe transparencën e çdo hapi të procedurës. Me rastin e anulimit të këtij aktiviteti të prokurimit, AK nuk ka respektuar asnjë nga dispozitat e nenit 62 të LPP-së. Gjithashtu, neni 43.5 i Rregullores Nr. 002/2024 është shumë i qartë sa i përket kushteve se kur një aktivitet i prokurimit mund të anulohet.

Arsyetimi i paraqitur nga AK në këtë rast bie ndesh si me dispozitat e LPP-së, ashtu edhe me kërkesat e nenit 43.5 të Rregullores për Prokurimin Publik, i cili specifikon qartë rastet kur një tender mund të anulohet pas hapjes së ofertave.

Për rrjedhojë, nuk ekziston asnjë bazë ligjore, as sipas LPP-së e as sipas Rregullores Nr. 002/2024 për Prokurimin Publik, që do të justifikonte anulimin e këtij aktiviteti të prokurimit nga ana e AK-së.

Neni 43.5 i Rregullores Nr. 002/2024 shprehet qartë se kur AK mund të anulojë një aktivitet të prokurimit, dhe arsyetimi i paraqitur në vendimin e AK-së është në kundërshtim të drejtpërdrejtë me këtë nen, ashtu si edhe me dispozitat e LPP-së. Rregullorja përcakton qartë rastet kur një tender mund të anulohet pas hapjes së ofertave, dhe rasti në fjalë nuk i plotëson këto kushte ligjore.

43.5 Procedura e prokurimit pas hapjes së ofertave duhet të anulohet për një nga arsyet e mëposhtme:

- a. *asnjë tender nuk është paraqitur brenda afatit të specifikuar;*
- b. *asnjëri prej tenderëve të pranuar nuk është i përgjegjshëm;*
- c. *numri i OE të përgjegjshëm për kontratë publike kornizë me më shumë se një OE është më pak se 3(tre);*
- d. *nuk ka kërkesa për të marrë pjesë, në procedurat e kufizuara ose konkurruese me negociata, që janë paraqitur brenda afatit të specifikuar;*
- e. *numri i kandidatëve të kualifikuar në procedurën e kufizuar/ konkurruese me negociata është më pak se 3;*
- f. *nuk ka projekte që janë paraqitur brenda afatit të specifikuar;*
- g. *asnjë nga projektet e pranuar në konkursin e projektimit nuk janë të përgjegjshëm;*
- h. *nëse urdhërohet nga Organi Shqyrtues i Prokurimit;*
- i. *një shkelje e ligjit ka ndodhur ose do të ndodhë dhe nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një ndryshimi;*
- j. *nëse AK gjatë përgatitjes dhe udhëheqjes se procedures ka përdorur gabimisht opcionin për procedurën përkatëse dhe i cili gabim me verifikim të KRPP-se është i pariparueshëm; ose*
- k. *nëse është paraqitur një gabim teknik në platformën e prokurimit elektronik nga ndonjë situatë e paparashikuar dhe jashtë kontrollit të AK dhe i cili gabim është i pariparueshëm sipas verifikimit dhe konstatimit nga KRPP.*

43.7 Procedura e prokurimit pas hapjes së ofertave mund të anulohet për arsyen e mëposhtme:

- a. ***të gjithë tenderët e përgjegjshëm përmbajnë çmime që e tejkalojnë buxhetin e AK.***

Për këtë arsye, si Operator Ekonomik, kërkojmë nga Autoriteti Kontraktues që të anulojë Vendimin e dates 14.04.2026 dhe të AK të respektimi e plotë i dispozitave ligjore të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP).

AK, duke përdorur këtë praktikë të anulimit në kundërshtim me LPP-në, ka shkelur dispozitat ligjore dhe ka bërë abuzim me parimet e prokurimit publik, duke mos respektuar në mënyrë të qartë nenin 7 të LPP-së, që përcakton parimet bazë të prokurimit publik, si transparenca, konkurrenca dhe barazia.

Ky veprim bie gjithashtu ndesh me nenin 97 të Rregullores Nr. 002/2024 për Prokurimin Publik, i cili specifikon rrethanat dhe procedurat për ndërprerjen ose anulimin e një aktiviteti të prokurimit. Për këto arsye, kërkojmë që AK të aprovojë Kërkesen tonë, pasi anulimi i tenderit është në kundërshtim me Ligjin për Prokurimin Publik (LPP), Nenin 62, si dhe me Rregulloren për Prokurim Publik nr. 002/2024 Për këto arsye, kërkojmë që AK të aprovojë Kërkesen tonë, pasi anulimi i tenderit është në kundërshtim me Ligjin për Prokurimin Publik (LPP), Nenin 59,62, si dhe me Rregulloren për Prokurim Publik nr. 002/2024 Nenin 30 dhe Neni 40.

Lidhur me pretendimin 1 shikon edhe Vendim e OSHP me nr. 2025/1237 dhe 2025/1250.

VENDIMI

Kërkesa për rishqyrtim aprovohet si e bazuar.

Vendimi i Autoritetit Kontraktues datë 14.04.2026 anulohet.

Lënda kthehet në rivlerësim për procedim të mëtejshëm sipas ligjit dhe Rregullores Nr. 002/2024.

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Diskriminimi në pjesëmarrjen në këtë aktivitet të prokurimit duke shkaktuar dëme materiale dhe financiare

9. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

- Dokumente relevante jane ne e-prokurim.